

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Ministritë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Titulli i prokurimit:	Furnizim me grurë për nevojat e Rezervave Shtetërore për vitin 2025
Nr. i prokurimit:	MINT204-25-9897-1-1-1
Nr. i brendshëm i prokurimit:	

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj:	Euro Ver Sh.P.K.
Adresa e plotë, vendi dhe kodi postar:	Rruga Qazim Dragusha, nr. 385, Prugovcë, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës
Numri Telefonit:	+383 44 112213
Numri i Faks-it:	NA
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj:	z. Bajram Selmani – Drejtor Menaxhues
Adresa elektronike:	contact@euro-ver.com / euro-ver@msn.com
Data e parashtrimit të kërkesës:	21.01.2026
Nënshkrimi dhe vula:	

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtrojë ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË. **NA**

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Njoftimi për Kontratë – 30.10.2025 Kërkesa për sqarim Autoriteti Kontraktues I – 19.12.2025 Sqarim Operatori Ekonomik Euro Ver SHPK – 22.12.2025 Kërkesa për sqarim Autoriteti Kontraktues II – 23.12.2025 Sqarim Operatori Ekonomik Euro Ver SHPK – 24.12.2025 Kërkesa për vërtetim tatimor dhe dëshminë nga Gjykata, si i rekomanduar – 23.12.2025; Vërtetimi tatimor ATK – 24.12.2025 Vërtetimi nga Gjykata – 24.12.2025 Njoftim mbi vendimin e AK – 29.12.2025 Kërkesa për Rishqyrtim të vendimit – 31.12.2025 Vendimi i AK për refuzim të kërkesës për rishqyrtim – 12.01.2026 Kriteri për dhënie të kontratës ka qenë “Çmimi më i ulët” .

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

Me dt. 29.12.2025, përmes platformës së E-Prokurimit, ne kemi pranuar nga AK MINT dokumentin “B42 - Letra Standarde për Ofertuesin e eliminuar” përmes të cilit na njofton se jemi eliminuar nga ky tender me arsyetimin, po citoj;

“Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

- 1. Vërtetimi nga Gjykata Themelore nuk është sipas njoftimit për kontratë dhe dosje të tenderit pasi që është pas datës së publikimit të njoftimit për kontratë si dhe është në kundërshtim me Neni 65 paragrafi 5 i LPP-së.**
- 2. Vërtetimi nga ATK nuk është sipas njoftimit për kontratë dhe dosje të tenderit pasi që është pas datës së publikimit të njoftimit për kontratë si dhe është në kundërshtim me Neni 65 paragrafi 5 i LPP-së.”**

mbyllet citati.

- **Provë: Dokumenti “B42 – Letra Standarde për Ofertuesin e eliminuar dt. 29.12.2025:**

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet të eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

AK MINT me dt. 23.12.2025, përmes platformës së E-Prokurimit na është drejtuar me kërkesë, në të cilën thuhet, po citoj;

“ Të nderuar/a,

Si Autoritet Kontraktues kemi shpallur procedurën e prokurimit për tenderin : “Furnizim me grurë për nevoja të Rezervave Shtetërore për vitin 2025”

Komisioni ka rekomanduar si fitues potencial për tenderi : “Furnizim me grurë për nevoja të Rezervave Shtetërore për vitin 2025”, ti jepet : EUROVER SHPK

Në dosjen tuaj nuk keni ofruar Vërtetimin nga Gjykata por sipas kërkesave në dosje të tenderit dhe të Udhëzimit Operativ U02 të nxjerr nga KRPP-ja neni 23.6: Vërtetim në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë do të kërkohej të dorëzohet nga një tenderues të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim dhënien e kontratës. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Dështim në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i tyre do të refuzohet, prandaj sipas kërkesave në dosje duhet sjelle:

1. Dëshmi se kompania nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor të lëshuar nga Gjykata kompetente - kërkohej origjinali ose kopje e vërtetuar jo më e vjetër se 90 ditë prej datës njoftimit për kontratë. (Duhet dorëzohet nga OE të cilit synohet dhënia e kontratës. (kërkohej origjinal ose kopje e vërtetuar nga organet kompetente);
2. Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve për tre mujorin e fundit prej datës njoftimit për kontratë. (Duhet dorëzohet nga OE të cilit synohet dhënia e kontratës.....(kërkohej origjinal ose kopje e vërtetuar nga organet kompetente);

Dokumenti duhet të dorëzohet vetëm nga tenderuesi potencial, para publikimit të dhënies së kontratës. Dështimi në dorëzim të dokumenteve të tilla, do të bëjë që tenderi i tyre do të refuzohet.

Informatat e kërkuara duhet të pranohen me shkrim në adresën e lartë shënuar të autoritetit kontraktues, me datën 29.12.2025, në orën 15:00. Dokumentet e kërkuar të ngarkohen në platformën e E-Prokurimit.

p.s. Në kuadër të dorëzimit të dokumenteve sipas kërkesës së lartë shënuar njëkohësisht ju duhet të dorëzoni në formë fizike edhe polisën e sigurimit të ofertës(origjinal) në Zyrën e Prokurimit. Nëse nuk

marrim përgjigje nga ju mbi pyetjet e lartë shënuara brenda afatit kohor të dhënë, tenderi juaj do të refuzohet.

mbyllet citati.

Ne si OE të rekomanduar për kontratë ne dt. 24.12.2025, kem ngarkuar ne platformën e E-prokurimit, dokumentet e kërkuara nga AK, si;

- **Dokumentin – Certifikatën e lëshuar nga Gjykata Komerciale e Kosovës e nr. A.Gj. 8639/2025 i datës 08.12.2025;**
- **Dokumentin – Vërtetimin Tatimor e lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosoves (ATK), me nr. 1001302661, i datës 08.12.2025;**

Vërejtje: Keto dy dokumente se bashku edhe me origjinalin e policës së sigurimit i kem dorëzuar edhe fizikisht ne zyrën e prokurimit të AK po me dt. 24.12.2025.

Me dt. 29.12.2025, përmes platformës se E-Prokurimit, nga AK ne kem pranuar dokumentin “B42 - Letra Standarde për Ofertuesin e eliminuar” përmes të cilit na njofton se jemi eliminuar nga ky tender, me arsyetimin, po citoj;

“Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak te arsyeve ne vijim:

- 1. Vërtetimi nga Gjykata Themelore nuk është sipas njoftimit për kontrate dhe dosje se tenderit pasi qe është pas datës se publikimit te njoftimit për kontrate si dhe është ne kundërshtim me Neni 65 paragrafi 5 i LPP-se.***
- 2. Vërtetimi nga ATK nuk është sipas njoftimit për kontrate dhe dosje se tenderit pasi qe është pas datës se publikimit te njoftimit për kontrate si dhe është ne kundërshtim me Neni 65 paragrafi 5 i LPP-se.”***

mbyllet citati.

Sipas vendimit të AK, arsyet për eliminimin e ofertës tonë, janë datat e dokumenteve tona, të cilat sipas AK janë ne kundërshtim me njoftimin për kontratë, dosjen e tenderit dhe me LPP neni 65 paragrafi 5.

Pra AK ka përdorur si arsyetim për eliminimin e ofertës tonë datën e lëshimit të këtyre dy dokumenteve dhe jo qëllimin që dëshmojnë keto dokumente ashtu si kërkon LPP, ku thuhet qe OE duhet të jete i përgjegjshëm konform nenit 65 të LPP se së paku deri në tremujorin e fundit prej datës se njoftimit për kontratë.

Çka nënkupton se AK ka pohuar se dokumentet e dorëzuara nga ne, si “Certifikata nga Gjykata” dhe “Vërtetimi tatimor nga ATK”, si dëshmi për përshtatshmërinë tonë, janë të lëshuar pas shpalljes së Njoftimit për tender dhe Dosjes së tenderit të datës 30.10.2025, dhe sipas asaj qe thuhet në arsyetimin e AK për eliminimin e ofertës tonë, sipas tyre këto dy dokumente është dashur qe të jenë të nxjerra para datës 30.10.2025, dhe atë jo më të vjetra se 90 ditë nga kjo datë.

Pra AK nuk e ka vlerësuar qëllimin qe dëshmojnë dokumentet ashtu si kërkohet ne LPP neni 65, por datën e lëshimit të tyre, çka bie në kundërshtim të plotë me ligjin, rregulloret dhe udhëzimet për prokurim.

Të pa kënaqur me këtë vendim antiligjor të zyrtarit të prokurimit të AK per eliminimin e ofertës tona nga tenderi, ne si OE me dt. 31.12.2025 kemi parashtruar “Kërkesën për Rishqyrtim” të këtij vendimi pranë AK. Duke listuar të gjitha faktet dhe argumentet qe e kundërshtoj vendimin e AK, dhe e vërtetojnë se ne si OE jemi plotësisht të përgjegjshëm për këtë tender, ashtu si e parasheh LPP neni 65 dhe rregulloret e prokurimit.

- ***Provë: Kërkesa për rishqyrtim e dt. 31.12.2025 me titull “Kërkesë për rishqyrtim-Euro Ver shpk 31.12.2025”;***

AK respektivisht zyrtari i prokurimit Bexhet Asllanaj, me dt. 12.01.2021 përmes vendimit nr. 86/03 na ka njoftuar se ka refuzuar kerkesen tonë si të pa bazuar, me arsyetimin, po citoj paragrafin 6 dhe 7 të faqes 2 të vendimit, si;

- “Për pretendimin ankimor tuaj se plotesoni kriterin për kerkesat e përshtatshmërisë lidhur me certifikatën e Gjykatës kompetente dhe vërtetimin tatimor të ATK-se nuk qëndron pasi dokumentet e kërkuar si i rekomanduar për kontrate të Gjykatës dhe të ATK-se nuk janë sipas njoftimit për kontrate dhe dosjen e tenderit ku për të dyja dokumentacione kërkohet jo më vjetër se 90 dite prej datës së njoftimit të kontrates që në këtë aktivitet të prokurimit data e njoftimit për kontrate është 30.10.2025, ndërsa ju si OE keni dorëzuar certifikatën e gjykatës dhe të vërtetimin tatimor të datës 08.12.2025 që është në kundërshtim me kërkesën e përshtatshmërinë e njoftimit për kontrate dhe në dosjen e tenderit. Ndërsa në përputhje me LPP Neni 65 në paragrafin 5, periudha kohore se në cilën periudhë duhet të jete OE i "pranueshëm", ndërlidhet me periudhën që menjëherë paraprinë datën e publikimit të njoftimit të kontrates, **që do të thotë se OE duhet të jete i "pranueshëm" në datën e publikimit të njoftimit, që në rastin tuaj certifikata e gjykatës dhe vërtetimi tatimor duhet të jete para datës së publikimit të njoftimit të kontrates.**” mbyllet citati

Prandaj, ne si pale e dëmtuar, duke u ballafaquar me këtë jo profesionalizimin dhe refuzimin kategorik të zyrtarit të prokurimit të AK për të zbatuar ligjin dhe kerkesat e DT-së, duke filluar nga refuzimi i dokumenteve tona të përshtatshmërisë, kërkesës tonë për rishqyrtim dhe vendimit për refuzimin e kërkesës tone për rishqyrtim, ne jem të detyruar që të vazhdojmë me këtë ankesë pranë OSHP për të kërkuar trajtimin e drejtë të ofertës tonë si dhe respektimin LPP-së dhe legjislacionit dytësor që rregullon procedurat e prokurimit në Republikën Kosovës.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontrates apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Veprimi i zyrtarit të prokurimit të AK bie ndesh me Ligjin për Prokurim Publik (LPP);

- Neni 1 paragrafi 1 dhe 2;
- Neni 7 paragrafi 1, 4 dhe 6;
- Neni 27;
- Neni 51 paragrafi 1, 2 dhe 3;
- Neni 64;
- Neni 56 paragrafi 3;
- Neni 65 paragrafët 3, 4 dhe 5;
- Neni 67 paragrafi 1 fjalia e parë, dhe paragrafi 2 nënpika (i);

Me Rregulloren 01/2022 plotësuar me rregulloren 02/2024;

- Neni 25 paragrafi 25.1 pika (a), 25.6, 25.9 dhe 25.10;
- Neni 38 paragrafi 38.5;
- Neni 40 paragrafi 40.12;

Dhe me Udhëzuesin për Prokurim nr.01/2023 plotësuar me udhëzuesin nr. 02/2024

- Neni 8 paragrafi 8.1 pika (1);
- Tabela faqe 20 deri 23 “Tabela e mëposhtme paraqet **Kriteret e përzgjedhjes** që mund të përdoren nga Autoriteti Kontraktues” – Kërkesat e Përshtatshmërisë – “Historiku i OE dhe menaxhmentit të tij për 10 vitet e fundit” pika (a, b, c, d, e, f), dhe “Historiku ekonomik – Sigurimi i besueshmërisë së OE” pika (a, b, c, d, e, f, g, h, i, j, k, l);
- Faqe 28, pika (i - Shënim për kërkesat e pranueshmërisë (neni 65 i LPP-së):

****Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.**

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

I. HYRJE

Pas pranimit të dokumenteve, e në veçanti të dokumentit “B42 – Letra Standarde për Ofertuesin e eliminuar”, dt. 29.12.2025, si dhe të Vendimit nr. 86/03, dt. 12.01.2026, punonjësit tanë kanë analizuar me kujdes të veçantë dhe profesionalizëm të plotë tërë dokumentacionin e këtij aktiviteti të prokurimit, duke filluar nga Njoftimi për Kontratë, Dosja e Tenderit, si dhe arsyetimet e përdorura nga zyrtari i prokurimit i Autoritetit Kontraktues (AK) për eliminimin e ofertës sonë dhe për refuzimin e kërkesës sonë për rishqyrtim. Nga kjo analizë është konstatuar se arsyetimet e AK-së janë **të paqëndrueshme, të padrejta dhe në kundërshtim të plotë me:**

- Njoftimin për Kontratë;
- Dosjen e Tenderit;
- Ligjin për Prokurim Publik (LPP);
- Rregulloren nr. 01/2022, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 02/2024;
- Udhëzuesin e Prokurimit nr. 01/2023, të plotësuar me Udhëzuesin nr. 02/2024;

II. Mospërputhja midis kërkesave të Njoftimit për Kontratë / Dosjes së Tenderit dhe arsyetimeve të AK-së

Në “Njoftimin për Kontratë” të datës 30.10.2025, pika III.2. kushtet për pjesëmarrje, nënpika III.2.1. kërkohet, po citoj;

Kërkesat e përshtatshmërisë:

1. Deklaratat nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit Prokurimit Publike, siç është e cekur në Pjesën, do të dorëzohen në formë të Aneksit;
2. Dëshmi se kompania nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor të lëshuar nga Gjykata Kompetente- kërkohet origjinali ose kopje e vërtetuar jo më e vjetër se 90 ditë prej datës së njoftimit për kontratë, (mos dorëzimi i kësaj dëshmie nuk do të diskualifikoj tenderin tuaj, por duhet dorëzohet nga OE te cilit synohet dhënia e kontratës);
3. Një vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit prej datës së njoftimit për kontratë, (mos dorëzimi i kësaj dëshmie nuk do të diskualifikoj tenderin tuaj, por duhet dorëzohet nga OE te cilit synohet dhënia e kontrates);

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Deklarata nën betim-kërkohet origjinal;
2. Vërtetimi nga Gjykata Themelore – kërkohet origjinali ose kopje e vërtetuar noterizuar;
3. Vërtetimi nga ATK - kërkohet origjinal apo kopje;

- **Provë: Njoftimi për kontratë dt. 30.10.2025.**

Në Dosjen e Tenderit, Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE TË Tenderit (FTD), neni 6.4. Kërkesat e përshtatshmërisë, kërkohet, po citoj:

Kërkesat e përshtatshmërisë:

1. Deklaratat nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit Prokurimit Publike, siç është e cekur në Pjesën, do të dorëzohen në formë të Aneksit;
2. Dëshmi se kompania nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor të lëshuar nga Gjykata Kompetente - kërkohet origjinali ose kopje e vërtetuar jo më e vjetër se 90 ditë prej datës së njoftimit për kontratë, (mos dorëzimi i kësaj dëshmie nuk do të diskualifikoj tenderin tuaj, por duhet dorëzohet nga OE te cilit synohet dhënia e kontratës);

3. Një vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit prej datës së njoftimit për kontratë, (mos dorëzimi i kësaj dëshmie nuk do të diskualifikoj tenderin tuaj, por duhet dorëzohet nga OE te cilit synohet dhënia e kontratës);

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Deklarata nën betim-kërkohet origjinal;
2. Vërtetimi nga Gjykata Themelore - kërkohet origjinali ose kopje e vërtetuar noterizuar;
3. Vërtetimi nga ATK - kërkohet origjinal apo kopje;

- Provë: Dosja e Tenderit – Seksioni II - FLETA E TË DHENAVE TË Tenderit (FTD);

Të nderuar zyrtar të OSHP-së, nese i analizoni me kujdes arsyetimet qe AK respektivisht zyrtar i prokurimit z. Bexhet Asllanaj i ka përdorë për eliminimin e ofertës tonë, si në njoftimin e datës 29.12.2025 “B42 - Letra Standarde për Ofertuesin e eliminuar” e po ashtu edhe në Vendimin e dt. 12.01.2025 nr. 86/03 për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim, dhe i krahasoni me dëshmitë e cekur ne Njoftimin për kontratë dhe DT-e, ju mund të vërtetoni, se;

1. Këto dy kërkesa nuk janë të ngjashme ne përmbajtje, ashtu si i përgjithëson zyrtari i prokurimit, sepse, derisa te Certifikata nga Gjykata kërkohet që, po citoj “ ***... kërkohet origjinali ose kopje e vërtetuar jo më e vjetër se 90 ditë prej datës së njoftimit për kontratë ...***”, te kërkesa e Vërtetimit nga ATK kërkohet po citoj “***...ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit prej datës së njoftimit për kontratë ...***”
2. Arsyetimet e zyrtarit të prokurimit për eliminimin e ofertës tonë janë ne kundërshtim me keto kërkesa, sepse ne dokumentin B42-Letra Standarde si arsyetim përdoret po citoj “*Vërtetimi nga Gjykata Themelore dhe Vërtetimi nga AK nuk është sipas njoftimit për kontratë dhe dosje se tenderit pasi qe është pas datës së publikimit të njoftimit për kontratë si dhe është në kundërshtim me Neni 65 paragrafi 5 i LPP-se*”, ndërsa ne Vendimin e datës 12.01.2026 përdoret po citoj paragrafin e parafundit faqe 2, “ *... dokumentet e kërkuara si i rekomanduar për kontratë, Vërtetimi i Gjykatës dhe ATK-së, nuk janë sipas njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit, ku për të dyja dokumentet kërkohet jo më të vjetra se 90 ditë prej datës së njoftimit të kontratës*”... qw ne rastin tuaj certifikata e gjykatës dhe vërtetimi tatimor duhet të jenë para datës së publikimit të njoftimit të kontratës”;
3. Po ashtu ky arsyetim bie ndesh edhe me njoftimin e datës 23.12.2025 “I rekomanduar” ku AK ka kërkuar nga ne si OE i përgjegjshëm të dorëzojmë dokumentet qe dëshmojnë përshtatshmërinë tone sipas LPP-se nenin 65, ne të cilin dokument ne paragrafin e tret nga fundi thuhet, po citoj “*Dokumenti duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi potencial, para publikimit të dhënies së kontratës.... Informatat e kërkuara duhet të pranohen me shkrim në adresën e lartë shënuar të autoritetit kontraktues, me datën 29.12.2025, në orën 15:00*”, kërkesë kjo e ardhur nga AK pas 63 dite pas njoftimit për kontratë.

Prandaj, vetëm nga keto krahasime, ju vërtetoni se keto arsyeime të zyrtarit të prokurimit bien kundërshtim mes asaj çka thuhet ne Njoftimin për kontratë dhe DT-e dhe përshkrimit tekstual qe zyrtari i prokurimi e ka përdor si arsyetim për eliminimin e ofertës tonë, sepse te kërkesa për Certifikatën nga gjykata e përshkruar ne Njoftimin për kontratë dhe DT-e kufizohet koha maksimale e vjetërsisë së dokumentit, qe do të thotë jo me e vjetër se 90 dite prej datës së shpalljes së njoftimit për kontratë dhe jo koha e nxjerrjes së këtij dokument pas datës së shpalljes së njoftimit për kontratë, dhe përmes këtij dokumentit kërkohet të dëshmohet se OE nuk është ne falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor, ndërsa te pika e dyte qe lidhet me Vërtetimin e ATK-se, kufizohet vetëm koha e parapagimit të tatimeve, ku përmes këtij dokumenti kërkohet të dëshmohet se OE nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit prej datës së njoftimit për kontratë, ashtu si e përcakton LPP neni 65 paragrafi 3 dhe 4, ndërsa ne anën tjetër arsyetimi i zyrtarit të prokurimit lidhet me kohen e nxjerrjes së dokumentit dhe dëshminë kohore që mbulojnë keto dokumente.

III. Keqinterpretimi dhe aplikimi i paligjshëm i nenit 65 të LPP-së

Ne kemi analizuar me shume kujdes edhe kërkesat e LPP-së neni 65 paragrafi 3, 4 dhe 5, kërkesat e Rregullores së Prokurimit 01/2022 plotësuar me Rregulloren 02/2024 si dhe Udhëzuesit të Prokurimit 01/2023 plotësuar me udhëzimin 02/2024, që lidhet me kërkesat dhe dëshmitë e dokumentuar mbi përshtatshmërinë e OE të cilëve një AK ka për qellim të i shpërblej me një kontratë publike.

Nëse i referohemi LPP-së neni 64 – Dëshmitë e Kërkesave, kërkohet, po citoj; *“Një kandidat ose tenderues do të dëshmoj me certifikatë, vërtetim apo dëshmi të tjera të mjaftueshme të kërkuara në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues që: (i) arsyet për mos-kualifikim sipas nenit 65 të këtij ligji nuk zbatohen; mbyllet citati.*

Ndërsa në LPP-së neni 65 - Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve, kërkohet, po citoj;

Neni -3;

3. Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluara;
 - 3.1. është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një veprë penale ose civile duke përfshirë praktikën e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme me ato të përshkruara në paragrafin 1. të nenit 130 të këtij ligji sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Kosovë ose në cilindo shtet, ose në çfarëdo marrëveshje ose konvente ndërkombëtare;
 - 3.2. është deklaruar i papërshtatshëm, kur autoriteti kontraktues zbulon se kjo është një shkelje e rëndë profesionale e konstatuar nga një gjykatë kompetente;
 - 3.3. është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një veprë penale serioze të pjesëmarrjes në aktivitetet e një organizate kriminale, që përkufizohet si asociacion i strukturuar dhe i krijuar gjatë një periudhe kohore dhe që vepron në mënyrë të organizuar me qëllim të përfitimit financiar përmes veprimeve që konsiderohen si kriminale ose të kundërligjshme në vendin ku ndodhin ato; ose
 - 3.4. është shpallur fajtor për mashtrim apo një akt të ngjashëm me mashtrim nga një gjykatë kompetente;
 - 3.5. është konstatuar nga një gjykatë kompetente, agjenci administrative ose organizatë për zbatimin e standardeve të sjelljes profesionale, se është sjellë në mënyrë joprofesionale; ose
 - 3.6. është konstatuar nga një gjykatë kompetente se ka bërë keqinterpretime para autoriteteve publike në Kosovë ose diku tjetër.

Neni-4;

4. Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik
 - 4.1. gjatë dy (2) viteve të kaluara është shpallur nga një gjykatë kompetente si i falimentuar ose insolvent, ose aktualisht është në procedurë: (i) të falimentimit, (ii) të pranimin të urdhrin për likuidim ose përmbyllje të aktiviteteve ose administrimit nga gjykata ose (iii) ndonjë procedurë tjetër të ngjashme sipas ligjit të Kosovës ose ndonjë juridiksioni tjetër.
 - 4.2. me vendim të një gjykate kompetente është likuiduar ose është vënë në mbikëqyrje të administratorit;
 - 4.3. aktualisht ka një marrëveshje ose aranzhim me kreditorët e tij që siguron kushte të zgjeruara ose të reduktuara të pagimit nëse mbi kushtet e tilla janë pajtuar paraprakisht kreditorët e tillë për shkak se operatori ekonomik më parë ka qenë i paaftë që të përmbushë obligimet e tij në afatin e duhur kohor;
 - 4.4. është në një situatë të ngjashme me ato të përshkruara në nën-paragrafët 4.1, 4.2. të këtij neni; ose 4.3 të këtij paragrafi që rrjedhin nga një procedurë e ngjashme sipas ligjeve në vendin ku është themeluar ose në vendin ku zhvillon veprimtarinë e tij afariste;
 - 4.5. aktualisht i nënshtrohet një vendimi gjyqësor ose administrativ i cili suspendon pagesat nga ose për një operatori të tillë ekonomik dhe që rezultojnë në një humbje të tërësishme ose të pjesshme

- të të drejtave të operatorit ekonomik për të administruar ose disponuar me pasurinë e tij.
- 4.6. aktualisht është lëndë e një vendimi gjyqësor ose administrativ i cili suspendon ose redukton pagesat nga ose për operatorët e tillë ekonomik nëse procedurat e tilla gjithashtu mund të rezultojnë në vendimin për falimentimin ose likuidimin e operatorit ekonomik;
- 4.7. gjatë tri viteve të fundit është konstatuar nga një gjykatë kompetente se nuk e ka përmbushur një kontratë me ndonjë njësi publike, autoritet publik ose ndërmarrje në Kosovë ose diku tjetër;
- 4.8. aktualisht është me vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë ose në vendin e themelimit të operatorit ekonomik, përveç ku një borxh i tillë është vërtetuar të jetë jo i rëndësishëm në Kosovë;
- 4.9. është më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë me vonesë në pagimin e pagave të punonjësve ose në pagimin e obligimeve ndaj një operatori të shërbimeve publike në Kosovë;
- 4.10. ende nuk e ka zbatuar një vendim të lëshuar nga një gjykatë e Kosovës; ose
- 4.11. ka dhënë deklarata të rreme në lidhje me procedurën për dhënien e një kontrate publike, nëse këto kanë të bëjnë me mungesën e arsyeve për përjashtim, ose me përmbushjen e kriterëve të përzgjedhjes.

Në Rregulloren për prokurim publik nr. 01/2022 plotësuar me Rregulloren nr. 02/2024 neni 25 Kriteret e përzgjedhjes, ne nenin 25 kërkohet, po citoj paragrafi 25.6 “AK do t’i pranojë si dëshmi të mjaftueshme që asnjëri prej rasteve të specifikuara në nenin 65 të LPP-së nuk aplikohet për OE-ik që marrin pjesë në aktivitetin e prokurimit ose në ekzekutimin e cilësdo kontratë publike, si më poshtë:

- Pika (b) - Në lidhje me Nenin 65, paragrafët 3.1, 3.2, 3.3, 3.4, 3.5, 3.6, 4.1, 4.2 dhe 4.4 të LPP-së, një ekstrakt nga "regjistri gjyqësor" apo, në mungesë të kësaj, një dokument ekuivalent i lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësor apo administrativ të vendit të themelimit të Operatorit Ekonomik;
- Pika (c) - Në lidhje me Nenin 65, paragrafi 4.8, për sigurimet sociale, dhe 4.9 të LPP-së, një certifikatë e lëshuar nga autoriteti kompetent ose Operatori publik që dëshmon se një situatë e tillë nuk ekziston;
- Pika (d) - Në lidhje me Nenin 65, paragrafi 4.8 të LPP-së, për kontributin e taksave një dëshmi e lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të Operatorit ekonomik;

Ndërsa ne paragrafi 25.9 thuhet po citoj “Vërtetimet në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë do të kërkohen të dorëzohen nga një tenderues të cilin Autoriteti Kontraktues ka për qëllim që ta shpërblejë me kontratë. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para publikimit të Njoftimit B58 mbi vendimin e AK-së. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është jo më pak se pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të autoritetit kontraktues për synimin e dhënies së kontratës” mbyllet citati.

Ndërsa në Udhëzues 002 2024 për plotësim ndryshim të Udhëzuesit 001 2023 për prokurimin Publik, neni 8 kërkohet, po citoj paragrafi 8.1 “Sipas Nenit 56 të LPP, një OE do të konsiderohet i kualifikuar për pjesëmarrje në aktivitet të prokurimit nëse- (1) Një OE vërteton të jetë i përshtatshëm sipas nenit 65 të LPP-së duke ofruar dëshmi të kërkuara nga autoriteti kontraktues” mbyllet citati.

Ndërsa në faqe 20 deri faqe 23 te tabela “Tabela e mëposhtme paraqet **Kriteret e përzgjedhjes** që mund të përdorën nga Autoriteti Kontraktues” që mund të kërkohen nga AK që të dëshmojnë nga OE që planifikon të i jap një kontratë, te pjesa “Kërkesat e Përshtatshmërisë”, kerkohen, po citoj;

Historiku i OE dhe menaxhmentit të tij për 10 vitet e fundit	
Kërkesa	Dëshmia Dokumentuese
a) Nuk është shpallur i fajshëm nga një gjykatë për praktika të korrupsionit;	a. Një vërtetim i lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësorë ose administrativ i vendit të themelimit të tenderuesit;
b) Nuk është deklaruar i papërshtatshëm nga një gjykatë kur autoriteti kontraktues zbulon se kjo është një shkelje e rende profesionale;	b. Një vërtetim i lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësorë ose administrativ i vendit të themelimit të tenderuesit;
c) Nuk është shpallur i fajshëm nga një gjykatë për pjesëmarrje në aktivitete të një organizate kriminele;	c. Një vërtetim i lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësorë ose administrativ i vendit të themelimit të tenderuesit;

d) Nuk është shpallur i fajshëm nga një gjykatë për kryerjen e një akti të mashtrimit ose një akti të ngjashëm;	d. Një vërtetim i lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësorë ose administrativ i vendit të themelimit të tenderuesit;
e) Nuk është shpallur nga një gjykatë kompetente, agjenci administrative ose organizatë për zbatimin e standardeve të sjelljes profesionale, se është sjellë në mënyrë joprofesionale;	e. Një vërtetim i lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësorë ose administrativ i vendit të themelimit të tenderuesit;
f) Nuk është shpallur nga një gjykatë kompetente se ka bërë keqinterpretime serioze;	f. Një vërtetim i lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësorë ose administrativ i vendit të themelimit të tenderuesit;

Ndërsa te pjesa Historiku ekonomik – Sigurimi i besueshmërisë së OE, kërkohet, po citoj (pikat a, b, h);

Historiku ekonomik – Sigurimi i besueshmërisë së OE	
Kërkesa	Dëshmia Dokumentuese
a) gjatë dy (2) viteve të kaluara është shpallur nga një gjykatë kompetente si i falimentuar ose insolvent;	a. Një vërtetim i lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësorë ose administrativ i vendit të themelimit të tenderuesit;
b) me vendim të një gjykatë kompetente nuk është likuiduar ose nuk është vënë në mbikëqyrje;	b. Një vërtetim i lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësorë ose administrativ i vendit të themelimit të tenderuesit;
h) nuk është me vonesë në pagimin e tatimeve ose kontributeve të sigurimit sociale	i. Në lidhje me tatimet një vërtetim i lëshuar nga administrata tatimore të vendit të themelimit që OE nuk është me vonesë në pagesën e tatimeve të paktën deri në çerekun e fundit të vitit;

Të nderuar zyrtar të OSHP-së, nga analizimi arsyetimeve që zyrtar i prokurimit i AK z. Bexhet Asllanaj i ka përdorë për eliminimin e ofertës tonë, në njoftimin e datës 29.12.2025 “B42 - Letra Standarde për Ofertuesin e eliminuar” e po ashtu edhe në Vendimin e dt. 12.01.2025 nr. 86/03 për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim, dhe krahasimi me dëshmitë dhe kërkesat ligjore të cituara me lartë dhe me përmbajtjen e dëshmimeve të certifikatës të lëshuar nga Gjykata Komerciale e Kosovës e nr. A.Gj. 8639/2025 të datës 08.12.2025, dhe Vërtetimit Tatimor të lëshuar nga ATK me nr. 1001302661, i datës 08.12.2025, ju mund të vërtetoni se keto arsyetime bien ne kundërshtim me kërkesat ligjore dhe dëshmitë e prezantuara nga ne lidhur me përshtatshmërinë tonë, për arsye se;

1. LPP-ja, Rregullorja për Prokurim Publik nr. 01/2022 plotësuar me Rregulloren nr. 02/2024 dhe Udhëzuesi për Prokurimin Publik 001/2023 plotësuar me udhëzuesin 002/2024, lidhur me përshtatshmërinë e OE të cilët kanë të drejtë të marrim pjesë në një tender publik dhe të shpërblehen me kontratë nga AK, përcaktojnë qartë llojet e dokumenteve (Certifikata, Vërtetime apo Deklarata nën Betim), kohen kur keto dokumente mund të kerkohen nga AK, kohen kur duhet të dorëzohen keto dokumente te AK, si dhe afatet kohore që duhet të mbulojnë keto dëshmi, që një OE të konsiderohet i përshtatshëm sipas kërkesave të ligjit dhe legjislacionit sekondar.
2. Përkufizimi kohor lidhur me datën e nxjerrjes se ketyre dokumenteve i përdorur nga zyrtari i prokurimit si arsyetim për eliminimin e ofertës tonë ne dokumentin “B42 - Letra Standarde për Ofertuesin e eliminuar” dhe “Vendimin e dt. 12.01.2025 nr. 86/03”, bien në kundërshtim me ligjin dhe legjislacionin sekondar, sepse në as një nen apo paragraf nuk precizohet apo kërkohet që dokumentet e përshtatshmërisë të kenë datën e lëshimit para datës se shpalljes se njoftimit të tenderit, por precizohet qartë vetëm koha e përshtatshmërisë që duhet dëshmuar përmes ketyre dokumenteve që një OE të konsiderohet i përshtatshëm për të marrim pjesë në një tender publik apo edhe të shpërblehet me kontratë. Çka do të thotë se OE duhet të dëshmojnë se së paku në 10 vitet e fundit nga data e shpalljes se njoftimit për kontratë nuk janë shpallur fajtor nga një gjykatë apo agjenci si dhe që nuk janë me vonesë në pagesën e kontributit të taksave së paku deri në tremujorin e fundit para datës së shpalljes së njoftimit për kontratë dhe se janë të përgjegjshëm sipas kërkesave të ligjit.

3. Udhëzuesi për Prokurimin Publik 01/2023 i plotësuar me udhëzuesin 002/2024, në faqe 28 pika (i) Shënim për kërkesat e pranueshmërisë (neni 65 i LPP-së), e përcakton shumë qartë qëllimin e kërkesave të përshtatshmërisë dhe pranueshmërisë për një OE, ku thuhet po citoj ***“Qëllimi i këtij kriteri është që të vlerësojë nëse tenderuesi i plotëson kërkesat e pranueshmërisë të përcaktuara me nenin 65 të LPP-së”*** mbyllet citati;
4. Se neni 67 paragrafi 1 i LPP-së e precizon shumë qartë organin kompetente (që është KRPP) për miratimin e rregullave, llojeve të dokumenteve, provave dhe deklaratave që një OE duhet të paraqes për të dëshmuar se ai nuk është i përjashtuar sipas dispozitave të nenit 65 të LPP-së, dhe në këtë rast nuk është kompetencë e zyrtarit të prokurimit të AK për të përcaktuar rregulla të reja dhe jashtë kërkesave ligjore për përshtatshmërinë e një OE;
5. Se në nenin 67 të LPP paragrafi 2 është precizuar shumë qartë ku thuhet se një Autoriteti kontraktues mund të e s’kualifikon çdo kandidat ose tenderues vetëm nese nuk paraqet: **(i) certifikatat ose dëshmitë e nevojshme për të treguar ose konfirmuar se ai nuk s’kualifikohet sipas nenit 65 të këtij ligji.**

Nese i analizojmë me kujdes dëshmitë tona të dorëzuar me dt. 28.12.2025, si Certifikatën e lëshuar nga Gjykata Komerciale e Kosovës e nr. A.Gj. 8639/2025 e datës 08.12.2025 dhe Vërtetimin Tatimor e lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), me nr. 1001302661, i datës 08.12.2025, lehtësisht vërtetohet se keto dokumente dëshmojnë dhe vërtetojnë se ne si OE jemi të përshtatshëm sipas kërkesave të LPP-se neni 65 paragrafi 3 dhe 4 për të marre pjese në këtë tender dhe të përgjegjshëm për tu shpërblyer me kontratë, dhe po ashtu edhe data e lëshimit dhe nxjerrjes së këtyre dokumenteve vërteton se të njëjtat nuk janë me të vjetra se 90 ditë nga data e shpalljes së këtij tenderit.

Për ne si OE, logjika e arsyetimit e zyrtarit të prokurimit të AK për të eliminuar ofertën tone dhe refuzimi i kërkesës për rishqyrtim të vendimit, jo vetëm që është antiligjore, por paraqet precedent shumë të rrezikshëm dhe një logjik plotësisht në kundërshtim me rregullat dhe procedurat ligjore që janë si baze për zhvillimin e procedurave të prokurimit në vendin tone.

Kjo logjik e arsyetimi nga zyrtarit të prokurimit të AK, përveç që bie në kundërshtim me ligjet dhe nenet e cituara, arsyetim ka kundërthënie edhe me vete përmbajtjen e tij si tërësi, sepse në këtë arsyetim zyrtari i prokurimit i AK në fq. 2 paragrafi i parafundit i vendimit nr. 86/03 e thotë, po citoj *“... që do të thotë se OE duhet të jete i "pranueshëm" në datën e publikimit të njoftimit”* (kërkesë të cilën e dëshmojnë dokumentet tona Certifikatën nga Gjykata Komerciale e Kosovës e nr. A.Gj. 8639/2025 e datës 08.12.2025 dhe Vërtetimin Tatimor nga ATK, me nr. 1001302661, i datës 08.12.2025), ndërsa në anën tjetër thotë, po citoj *“... në rastin tuaj certifikata e gjykatës dhe vërtetimi tatimor duhet të jete para datës së publikimit të njoftimit të kontrates”*, duke shtuar kriteret të jashtë ligjshme dhe të papërcaktuara me ligj.

Për ne, logjika e zyrtarit të prokurimit që një certifikate e gjykatës dhe ATK-se për të qenë të pranueshme për të dëshmuar gjendjen e OE sipas kërkesave të LPP neni 65, duhet të jenë të nxjerra vetëm para datës së publikimit të tenderit dhe duhet të jenë jo me të vjetra se 90 ditë nga kjo datë, përbën vendosje të një kushti objektivisht të pamundur për t’u përmbushur nga as një OE dhe në kundërshtim me parimet themelore të së drejtës administrative dhe të prokurimit publik, si dhe kriter diskriminues ndaj OE të caktuar.

Sipas kesaj logjike të zyrtarit të prokurimit, nënkupton që një OE mund të jete i përgjegjshëm vetëm nese është në koordinim të plotë me zyrtarin e prokurimit, dhe me kohë i ka të gjitha informatat kur ai planifikon të e publikoj një tender, kështu që OE të mund të nxjerr me kohë keto dokumente dhe të përgatitet para datës së publikimit të një tenderi.

Një informacion tjetër që është i rëndësishëm lidhur me aktivitetin në fjalë, dhe që ngreh dyshime për veprimet e zyrtarit të prokurimit të AK, është fakti se AK MINT sipas planit përfundimtar të prokurimit për vitin 2025 të publikuar në E-Prokurim, këtë aktivitet e kishte të planifikuar ta publikonte në muajin Maj

2025, kurse pa dhënë as një arsytim për vonesat, tenderin e ka publikuar vetëm në fund të muajit Tetor 2025, duke përcaktuar afatin e realizimit të kontratës vetëm 15 dite nga nënshkrimi.

Nga përvoja jonë në fushën e ofertimit në tenderët publik në vendin tonë, si dhe nga hulumtimi në faqen e E-Prokurimit, si dhe analizimin e Njoftimeve dhe Opinioneve të KRPP-se, ne në asnjë rast nuk kemi hasur një vendim si ky i zyrtarit Bexhet Asllanaj.

Ligji i prokurimit publik si dhe praktikën e prokurimit në vendin tonë, e sidomos dosjet e tenderit në nenin 6.4 të FDT e rregullojnë qarte kur duhet të kërkojnë këto dokumente të përshtatshmërisë, nga cili OE, dhe kohen kur duhet të dorëzohen, çka do të thotë se këto dokumente kërkojnë vetëm pas vlerësimit të ofertave (që sipas praktikave zgjasin shpesh herë javë apo muaj pas publikimit të njoftimit për kontratë dhe hapjes së ofertave), dhe atë vetëm nga OE të cilin AK planifikon të shpërblejë me kontratë, dhe duhet të dorëzohen me se voni 5 ditë nga data e parashtrimit të kërkesës nga AK, çka parimisht dhe ligjërisht e vërteton se këto dokumente nuk mund të jenë me data para njoftimit për kontratë, sepse kërkojnë pas datës së hapjes së ofertave dhe pas vlerësimit të ofertave, prandaj ligjërisht dhe fizikisht këto dokumente nuk mund të lidhen apo kushtëzohen me datat para shpalljes së tenderit, por këto lidhen me dokumentimin e përshtatshmërisë së një OE ashtu si kërkojnë në ligj. Kjo praktikë është e rregulluar dhe e precizuar në LPP dhe rregulloret e nxjerra nga KRPP-ja, dhe obligative për tu zbatuar gjerësisht nga secili AK në vendin tonë, dhe nuk është konsideruar asnjëherë si shkelje e nenit 65 të LPP-së paragrafi 5, për atë kohë sa dokumentet e dorëzuara nga një OE dëshmojnë përshtatshmërinë reale të tij sipas kërkesave ligjore.

IV. Shkelja e parimit të barazisë dhe arsytimi i gabuar dhe i paligjshëm i AK;

Të nderuar zyrtar të OSHP-së, duke analizuar dokumentet e këtij tenderi, si Njoftimin për Kontratë, Dosjen e Tenderit, Ligjin për Prokurim Publik (LPP), Rregulloren nr. 01/2022, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 02/2024, Udhëzuesin e Prokurimit nr. 01/2023, të plotësuar me Udhëzuesin nr. 02/2024, dokumentin, në njoftimin e “B42 - Letra Standarde për Ofertuesin e eliminuar” të datës 29.12.2025, Vendimin e dt. 12.01.2025 nr. 86/03, Certifikatën e lëshuar nga Gjykata Komerciale e Kosovës e nr. A.Gj. 8639/2025 të datës 08.12.2025, dhe Vërtetimit Tatimor të lëshuar nga ATK me nr. 1001302661 të datës 08.12.2025, ju do të vërtetoni se veprimet e zyrtarit të prokurimit të AK përveç që bien në kundërshtim me ligjet dhe dokumentet e cituar, dhe ato paraqesin edhe qasje diskriminuese ndaj neve si OE dhe qëllimit të këtij tenderi në tërësi, për arsye se;

1. Logjika e arsytimit dhe veprimi i zyrtarit të prokurimit të AK për të eliminuar ofertën tonë bie ndesh edhe me LPP neni 1 paragrafi 1 ku thotë po citoj *“Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla”*, sepse veprimi i zyrtarit të prokurimit është në kundërshtim me qëllimin e këtij tenderi dhe politikat strategjike të MINT lidhur me sigurimin e rezervave shtetërore;
2. Qëndrimi dhe veprimi i mbajtur nga zyrtari i prokurimit i AK në këtë rast paraqet devijime nga praktikën e deritashme të konsoliduar administrative dhe të miratuara nga KRPP, si dhe aplikim selektiv në këtë procedurë, me një precedent plotësisht të paligjshëm dhe të rrezikshëm për të ardhmen e fushës së prokurimit, të cilat paraqesin trajtim të pabarabartë ndaj neve si OE, i cili veprim sanksionohet me nenin 7 të LPP-së;
3. Veprimi dhe qëndrimi i zyrtarit të prokurimit të AK bie ndesh me nenin 27, dhe nenin 56 të LPP-së, paragrafi 3 respektivisht Rregulloren për prokurim publik nr. 01/2022 e plotësuar me rregulloren nr. 02/2024, neni 40 paragrafi 40.12 ku thuhet po citoj; *“Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit”*, sepse zyrtari i Prokurimit ka përdorur kriter

të pa ligjeshme dhe të papërcaktuar në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë për eliminimin e ofertës tonë;

4. Veprimi dhe arsyetimi i zyrtarit të prokurimit për eliminimin e ofertës tonë bien në kundërshtim edhe me neni 51 të LPP-së, paragrafi 1 në fjalinë e fundit thotë, po citoj “... Në asnjë rast, autoriteti kontraktues nuk duhet që të përfshijë, saktësojë ose përdorë kritere të përzgjedhjes që bazohen në konsiderata të tjera përveç atyre të lejuara nga dispozitat e neneve 65-70 të këtij ligji” dhe sidomos me paragrafin 2 në fjalinë e fundit ku thotë, po citoj “... Në asnjë rast njoftimi i kontratës ose dosja e tenderit nuk do të kërkojnë nga operatori i interesuar ekonomik që të dorëzojë dokumente ose informata që nuk kërkohen ose nuk janë në përputhshmëri me nenet 65-70 të këtij ligji”;
5. Veprimi dhe arsyetimi i zyrtarit të prokurimit për eliminimin e ofertës tonë dhe refuzimin e dokumenteve lidhur me përshtatshmërinë tonë, janë në kundërshtim edhe me Rregulloren për prokurim publik nr. 01/2022 e plotësuar në rregulloren nr. 02/2024, neni 25 paragrafi 25.6, 25.9 dhe 25.10, dhe sidomos me paragrafin 25.1 pika (a) e cila thotë, po citoj “a. Një OE vërteton të jetë i përshtatshëm sipas nenit 65 të LPP-së duke ofruar dëshmi të kërkuara nga autoriteti kontraktues”;
6. Veprimi dhe arsyetimi i zyrtarit të prokurimit për eliminimin e ofertës tonë dhe refuzimin e dokumenteve lidhur me përshtatshmërinë tonë, janë në kundërshtim edhe me Udhëzuesin për prokurim publik nr. 01/2023 plotësuar me udhëzuesin nr. 02/2024, neni 8 paragrafi 8.1 pika (1) të këtij udhëzimi, i cili thotë, po citoj “Sipas Nenit 56 të LPP, një OE do të konsiderohet i kualifikuar për pjesëmarrje në aktivitetet e prokurimit nëse: Një OE vërteton të jetë i përshtatshëm sipas nenit 65 të LPP-së duke ofruar dëshmi të kërkuara nga autoriteti kontraktues”;
7. Veprimi dhe arsyetimi i zyrtarit të prokurimit për eliminimin e ofertës tonë dhe refuzimin e dokumenteve lidhur me përshtatshmërinë tonë, janë në kundërshtim edhe me Udhëzuesin për prokurim publik nr. 01/2023 plotësuar me udhëzuesin nr. 02/2024, kërkesat e përcaktuara në “Tabela e mëposhtme paraqet **Kriteret e përzgjedhjes** që mund të përdoren nga Autoriteti Kontraktues” faqe 20 deri 23 të këtij udhëzimi kapitulli “Kërkesat e Përshtatshmërisë”, çështja lidhur me “Historiku i OE dhe menaxhmentit të tij për 10 vitet e fundit” dhe “Historiku ekonomik – Sigurimi i besueshmërisë së OE”, ku janë të përcaktuara qartë kërkesat ligjore që i ndalojnë një OE pjesëmarrjen në një aktivitet të prokurimit, si dhe janë të përcaktuara qartë “Dëshmitë dokumentues” që një OE duhet të i dorëzojë një AK për të i dëshmuar se ai nuk është në kundërshtim me keto kërkesa ligjore;
8. Veprimi dhe arsyetimi i zyrtarit të prokurimit për eliminimin e ofertës tonë dhe refuzimin e dokumenteve lidhur me përshtatshmërinë tonë, janë në kundërshtim edhe me Rregulloren për prokurim publik nr. 01/2022 e plotësuar në rregulloren nr. 02/2024, neni 38 paragrafi 38.5 i kësaj rregullore, i cili thotë po citoj “38.3 Megjithatë, lejohet që një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkojë dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyrë objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve”, sepse zyrtarit të prokurimit nëse ka pasuar nevojë për informata ka mundur të kërkojë sqarime shtese lidhur me dokumentet e dorëzuara nga ne;

Se zyrtari i prokurimit i AK z. Bexhet Asllanaj, përdor standardë të dyfishta, për të eliminuar ofertën tonë, tregon edhe rasti tjetër, që po citojmë me poshtë, si;

Me dt. **20.10.2021** po ky AK dhe ky zyrtar kishte shpallur tenderin me nr. MINT-204-21-8024-1-1-1, dhe në FDT neni 6.4. pika 2 dhe 3 kishte kërkuar po citoj:

1. Dëshmi se kompania nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor të lëshuar nga Gjykata Themelore- kërkohet origjinali ose kopje e vërtetuar jo më e vjetër se 30 ditë, (mos dorëzimi i kësaj dëshmie nuk do të diskualifikoj tenderin tuaj, por duhet dorëzohet nga OE të cilit synohet dhënia e kontratës);
2. Një vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore i vendit tuaj të themelimit se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit, (mos dorëzimi i kësaj dëshmie

nuk do të diskualifikoje tenderin tuaj, por duhet dorëzohet nga OE te cilit synohet dhënia e kontratës).

Dhe ne këtë tender ne si OE kishim ofertuar, dhe se bashku me dokumentet e ofertës kishim bashkangjitur edhe dokumentet si certifikata nga Gjykatat me nr. AGJ.nr.8297/21 e dt. 09.11.2021, dhe vërtetimin nga administrata tatimore nr. 1000836655 i dt. 10.11.2021, çka nënkupton se keto dy dokumente ishin nxjerr nga organet kompetente 20 ditë pas shpalljes së tenderit.

Ne këtë rast zyrtari i prokurimit Bexhet Asllanaj i kishte pranuar keto dokumente si të rregullta dhe të mjaftueshme dhe me dt. 14.12.2021 na kishte shpallur fitues, ndërsa me dt. 21.12.2021 ne kemi nënshkruar edhe kontratën me AK.

- *Provë: Dosja dhe dokumentet e këtij tenderi ne faqen e E-Prokurimit;*

V. KONKLuzionet Përfundimtare

Duke u bazuar në të gjitha të gjeturat e lartcekura kuptohet dhe vërtetohet qartë se vendimi i zyrtarit të prokurimit pranë AK MINT të cekura në njoftimin e “B42 - Letra Standarde për Ofertuesin e eliminuar” të datës 29.12.2025, Vendimin e dt. 12.01.2025 nr. 86/03, nuk është në përputhje me Njoftimin për Kontratë, Dosjen e Tenderit, Ligjin për Prokurim Publik (LPP), Rregulloren nr. 01/2022, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 02/2024, Udhëzuesin e Prokurimit nr. 01/2023, të plotësuar me Udhëzuesin nr. 02/2024, dokumentin, Certifikatën e lëshuar nga Gjykata Komerciale e Kosovës e nr. A.Gj. 8639/2025 të datës 08.12.2025, dhe Vërtetimit Tatimor të lëshuar nga ATK me nr. 1001302661 të datës 08.12.2025, prandaj **kërkojmë nga OSHP që të nxjerr;**

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE EURO VER SHPK, dhe të

ANULOHET, vendimi i zyrtarit të prokurimit i AK Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) i dt. 29.12.2025 dhe lënda të kthehet në **RIVENDOSJE**.

Dhe gjatë rivendosjes Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) të kujdeset që ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni të plotë me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të Ligjit për Prokurim Publik, Rregullores për Prokurim Publik 01/2022 plotësuar me rregulloren 02/2024 dhe Udhëzuesin për prokurim publik 01/2023 plotësuar me udhëzuesin 01/2024 për Prokurim Publik, dhe OE EURO VER shpk të shpallet i përgjegjshme dhe fitues i këtij tenderi.

9. Dëmet materiale

Përshtetja mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Vlerësimi i gabuar nga AK na shkakton dëme materiale, financiare dhe në reputacion e kompanisë tonë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime); të bashkangjitura;

- Dokumentet që i referohen furnizimit në vitin 2021, i gjeni në sistemin Eprokurimi.

Vërejtje:

Dokumentet e këtij aktiviteti gjenden në platformën e E-Prokurimit, nëse keni nevojë për ndonjë sqarim apo informate shtesë ne si OE mund të ju dërgojmë në kërkesën tuaj të pare. Si dhe cdo informacion që ju mendojnë se ju nevojitet, apo edhe kërkesë për prezencë në një seancë dëgjimore apo sqarues.